

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 3 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 41 paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 3 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, duke vendosur pas Njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive LAJF RADIO SHPKNJP Shkup, ark.nr.84/23 datë 13.10.2023 (nr. ynë PA1 nr.02-335 datë 13.10.2023), në pajtim me Konkluzionin e Këshillit ark.nr.02-3836/3 datë 26.10.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 34-të mbajtur më 26.10.2023 miratoi si vijon:

VENDIM

1. LEJOHET ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive LAJF RADIO SHPKNJP Shkup, dhe atë:

- për përfaqësim të personit fizik [REDAKTUAR] (i mëparshëm nga [REDAKTUAR]), me NVAQ [REDAKTUAR] dhe vendbanim të fundit në rr.„[REDAKTUAR] dhe
- për përfaqësim të personit fizik Afërdita Fetau (bashkëshortja e Kreshnik Ajdinit – i mëparshëm nga Shkupi), me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rr.„[REDAKTUAR] nr.[REDAKTUAR].

2. Detyrohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive LAJF RADIO SHPKNJP Shkup, pas ndryshimit të kryer paraqitur në pikë 1 të këtij Vendimi, drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të dorëzon gjendjen aktuale vijuese të dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim hyn në fuqi me ditën e miratimit.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) LAJF RADIO SHPKNJP Shkup, në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.171/14), me Njoftimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë ark.nr.84/23 datë 13.10.2023 (nr. ynë PA1 nr.02-335 datë 13.10.2023), e njoftoi Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) për qëllimin e tij për zbatim të ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR LAJF RADIO SHPKNJP Shkup.

Njoftimi i dorëzuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë ark.nr.84/23 datë 13.10.2023 (nr. ynë PA1 nr.02-335 datë 13.10.2023), nga ana e SHTR LAJF RADIO SHPKNJP Shkup, u konstatua se është i plotë dhe i rregullt, respektivisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë.

Përkatësisht, për shkak të vdekjes së pronarit të SHTR LAJF RADIO SHPKNJP Shkup ([REDAKTUAR] – i mëparshëm nga Shkupi), është kërkuar pëlqimi për përfaqësim të personit fizik Afërdita Fetau, me NVAQ 0501968455140 dhe adresë në rr.[REDAKTUAR]. Në pajtim me Vendimin ON.NOV nr.3164/23, UDR nr.64/23, i plotfuqishëm me datë 12.9.2023, pas zbatimit të procedurës trashëgimore, personi [REDAKTUAR], bashkëshortja e trashëgimlënësit, është shpallur për trashëgimtar ligjor i së drejtës: të investimit themelor jomonetar në shumë prej 2.842.700,00 denarë, në Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive LAJF RADIO SHPKJP Shkup, me NVAS 4867793, evident nga gjendja vijuese e personit juridik nr.0805-50/150020230233165 datë 12.9.2023 e dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Agjencia, me qëllim që të hetojë nëse me ndryshimet e propozuara të strukturës së pronësisë të SHTR LAJF RADIO SHPKNJP Shkup do të krijojnë koncentrim të paligjshëm mediatik, respektivisht nëse janë në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga LSHMAAV, nëpërmjet Sistemit të Shpërndarjes së Internetit të Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), ofroi

¹Алинеите 8 и 9 се избришани, види: член 8 од Закон за изменување и дополнување на Законот за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги („Службен весник на Република Македонија“ бр.248/18).

„Informacion për subjektet (personat e autorizuar, organeve drejtuese, pronarë në subjekte të tjera) – llogarinë rrjedhëse“, numër 0820-50/150020230280203 datë 17.10.2023, nga ku rezulton se personi [REDAKTUAR] figuron vetëm si drejtuese e SHTR LAJF RADIO SHPKNJP Shkup (ky person juridik nuk figuron si pronar i shoqërive tregtare).

Po ashtu, Agjencia ka kryer kontroll dhe në Regjistrin e pronarëve të vërtetë (përfitues), të mbajtur nga Regjistri Qendror i RMV-së, nga ku siguroi dokumentin „Llogari rrjedhëse për personin fizik – pronar i vetëm“, numër 2007-50/150020230280218 datë 17.10.2023, nga e cila u vërtetua se personi [REDAKTUAR] nuk paraqitet si pronar i vërtetë i shoqërive tregtare.

Pas ndryshimit të kryer të strukturës së pronësisë, pronar i vetëm i SHTR LAJF RADIO SHPKNJP Shkup do të figuron personi fizik [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rr., [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR].

Duke pasur parasysh konstatimin e Agjencisë se me zbatimin e ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR LAJF RADIO SHPKNJP Shkup nuk paraqitet koncentrim i paligjshëm mediatik në kuptim të LSHMAAV, respektivisht se ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë, pas Njoftimit të paraqitur për ndryshimin e strukturës së pronësisë ark.nr.84/23 datë 13.10.2023 (nr. ynë PA1 nr.02-335 datë 13.10.2023), Këshilli i Agjencisë, miratoi vendim si në dispozitiv.

Nr.02-335

27.10.2023
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi radiodifuzeri, nëse është i pakënaqur nga vendimi, ka të drejtë që në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit, të ngrejë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.